



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT DHE
ÇËSHTJEVE TË TREGËTISË
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TREGUT TË BRENDSHËM

Nr. 2009/2
prot.

Tiranë, më 20.01.2026

URDHËR

Nr. 32, Datë 20.01.2026

**“PËR
PËRSHKRIMIN E SHENJËS DALLUESE “INSTRUMENT MATËS JO NË
PËRDORIM” TË INSTRUMENTEVE MATËSE QË JANË NË VENDIN E
PËRDORIMIT, POR NUK JANË VERIFIKUAR SIPAS PROCEDURAVE TË
PËRCAKTUARA NË LIGJIN PËR METROLOGJINË”**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 19, dhe të pikës 2 të nenit 57, të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë,

URDHËROJ:

1. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që janë në vendin e përdorimit, por nuk janë verifikuar sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për metrologjinë”, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtij shërbimi nga ana e personave juridikë privatë, duhet të shënohen me pullën përkatëse “*instrument matës jo në përdorim*”, sipas përshkrimit në Aneksin nr.1. “Pulla “*instrument matës jo në përdorim*”, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

Në rastet e instrumenteve matëse me dimensione të mëdha, pulla “*instrumenti matës jo në përdorim*” duhet të shoqërohet me shirit me logo të DPM dhe mbishkrim të njëjtë si tek pulla “*Instrument matës jo në përdorim*”.

2. Përdorimi i pullës sipas pikës 1, në rastet e mëposhtme:

- a) Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, janë në vendin e përdorimit, por që përdoruesi nuk i përdor dhe kur është e pamundur largimi i tyre nga vendi i përdorimit. Në këtë rast, kur është e mundur shenja të shoqërohet me plumbosje mekanike, ku plumbcja të ketë logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë;
- b) Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që janë subjekt i kontrollit metrologjik, që për arsye nga më të ndryshmet, nuk mund të riparohen më, apo janë shkatërruar tërësisht, duhet të hiqen nga përdorimi. Deri në momentin e largimit nga vendi i përdorimit, këta instrumente matëse ligjërish të kontrolluara, duhet të shënohen me pullën “*instrument matës jo në përdorim*”. Afati për largimi përfundimtar të këtyre instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, nga vendi i përdorimit, në çdo rast nuk duhet të jetë më tepër se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shënimit të tij me pullën “*instrument matës jo në përdorim*”.
- c) Për rastet kur instrumentet janë pjesë e një sistemi të tërë:

30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shënimit të tij me pullën “*instrument matës jo në përdorim*”.

c) Për rastet kur instrumentet janë pjesë e një sistemi të tërë:

- i cili nuk është dëmtuar tërësisht, por vetëm një pjesë e tij dhe bëhet i pamundur largimi i të gjithë sistemit, në kushtet kur ky instrument nuk ndikon në sistem, instrumenti duhet të shënohet me pullën “*instrumenti matës jo në përdorim*”; dhe
- instrumenti i dëmtuar, ndikon në sistem, duhet shënuar gjithë sistemi me pullën “*instrument matës jo në përdorim*”.

Afati për zëvendësimin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluara nga sistemi, në çdo rast nuk duhet të jetë më tepër se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shënimit të tij me pullën “*instrument matës jo në përdorim*”.

3. Shënimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sipas rasteve të përshkruara në pikën 2, të këtij urdhri, duhet të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe nga subjektet e autorizuar prej saj, për fushat që mbulojnë.

4. Kërkesën për shënim të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluara, me pullën përkatëse “*instrument matës jo në përdorim*”, sipas pikës 2, të këtij urdhëri, mund ta paraqes:

- a) Personi juridik/personi fizik, përdorues i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;
- b) Institucione shtetërore.

5. Heqja e shenjës “*instrument matës jo në përdorim*”, realizohet kur:

- a) Përdoruesi i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar bën kërkesë, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për heqjen e shenjës “*instrument matës jo në përdorim*” dhe verifikim jashtë radhe të instrumentit matës, pasi do e rivendosë në përdorim instrumentin matës ligjërisht të kontrolluar;
- b) Përdoruesi i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, pasi kanë përfunduar procedurat e riparimit të instrumentit matës.

6. Në çdo rast vendosja e shenjës ose heqja e saj, shoqërohet me plotësimin e Procesverbalit Tip “Procesverbal për vendosjen/heqjen e shenjës “*instrumenti matës jo në përdorim*”, sipas Aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij, i cili mbahet në 3 (tre) kopje dhe firmoset nga punonjësi/it i/e DPM-së dhe nga përfaqësuesi i subjektit.

7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Subjektet e autorizuar prej saj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTËR

Delina Ibrahimaj

Adresa: Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë



Aneksi nr. 1: Pulla "instrument matës jo në përdorim"



Shënime:

Pulla "instrument matës jo në përdorim", duhet të jetë në formë drejtëkëndore, me përmasa 3 cm (gjerësia) dhe 5 cm (gjatësia). Në rastet e instrumenteve matëse me dimensione të mëdha, pulla "instrumenti matës jo në përdorim" duhet të shoqërohet me shirit me logo të DPM dhe mbishkrim të njëjtë si tek pulla "Instrument matës jo në përdorim".

Pulla duhet të ketë kontur të dyfishtë, ngjyrë të zi.

Hapësia e brendshme e pullës është e ndarë në 4 pjesë, dy e nga dy identike, prej heqjes së 2 (dy) diagonaleve.

Në pjesën e sipërme, në qendër, duhet të shënohet teksti "**REPUBLIKA E SHQIPËRISË, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**", me shkronja kapitale.

Pjesa e poshtme e pullës, në qendër, duhet të ketë mbishkrimin "**INSTRUMENT MATËS JO NË PËRDORIM**" me shkronja kapitale.

Pjesa e majtë e pullës, në qendër, duhet të ketë logon zyrtarë të DPM-së.

Pjesa në të djathtë, në qendër, duhet të ketë Nr. Serial të pullës, i cili duhet të jetë 6 shifror, duke filluar nga 000001.

Letra duhet të jetë me sfond të bardhë, me shkëlqim dhe me ngjitje në pjesën e mbrapme (adezive). Duhet të jetë e shkatërrueshme gjatë heqjes së saj.

Aneksi nr. 2
Procesverbal për vendosjen/heqjen e shenjës “instrument matës jo në përdorim”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

PROCESVERBAL
PËR VENDOSJEN/HEQJEN E SHENJËS
“INSTRUMENT MATËS JO NË PËRDORIM”

Nr. (Emri i Inst.-Viti-Nr.serial i pullës)
(p.sh.: DPM – 2025 - 000001)

Datë: dd/mm/yyyy

Në zbatim të nenit 19, të ligjit nr.126/2020, “Për Metrologjinë”, Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. _____, datë _____.2025, “Përshkrimi i shenjës dalluese “instrument matës jo në përdorim” të instrumenteve matëse që janë në vendin e përdorimit, por nuk janë verifikuar sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.126, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar.

I. Të dhëna të përgjithshme:

1. Emri i subjektit: _____
2. NIPT: _____
3. Adresa/vendndodhja e instrumentit matës: _____
4. Përfaqësuesi i Subjektit: (emër atësi mbiemër) _____
5. Arsyeja e shënimit me pullë të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar. _____

II. Të dhëna për instrumentin matës ligjërisht të kontrolluar:

1. Emri: _____
2. Prodhuesi: _____
3. Tipi: _____
4. Nr.serial: _____
5. Data e hedhjes në treg/vendosjes në përdorim: _____
6. Data e verifikimit periodik të fundit/miratimit të tipit: _____
7. Riparime të mundshme, të mëparshme: ☐ Po ☐ Jo

III. Konkluzioni:

Vendosja/heqja e shenjës “instrument matës jo në përdorim”, me nr. serial _____.

Ky procesverbal u mbajt sot më datën ____/____/____, në tre kopje.

Punonjësi/it e DPM-së:

Përfaqësuesi i Subjektit:

